



Republika e Kosovës  
Republika Kosovo-Republic of Kosovo  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

Legjislatura IV  
Seksioni pranveror

Nënkomisioni për Mandate, Imunitet dhe Rregullore të Kuvendit

### **Procesverbal**

Mbledhja e mbajtur me 14.05.2013, duke filluar në orën 11:00

Në mbledhje morën pjesë: Armend Zemaj, kryetar, Albulena Haxhiu dhe Mufera Sinik, anëtarë.

Munguan: Behar Selimi, Ardian Gjini, Gëzim Kelmendi dhe Jasmina Zivkovic, anëtarë

Nga Zyra mbështetëse morën pjesë: Fehmi Hyseni dhe Advie Morina;

Mbledhjen e kryesoi Armend Zemaj, kryetar i Nënkomisionit.

### **Rendi i ditës**

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
- 3 Shqyrtimi i Projektligjit për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Deputetit;
4. Te ndryshme.

Armend Zemaj- kryetar i nënkomisionit konstatoi se pasi që kësaj rradhe po mungojnë 4 anëtarë të nënkomisionit dhe nuk ka kuorum, po diskutojmë për këto çështje pa marrë vendime. Lidhur me këtë projektligji nënkomisioni ka pranuar disa propozime të reja që kanë të bëjnë me pensionet e deputetëve. Pas shqyrtimit të këtyre propozimeve në mbledhjen e radhës, pritet që të miratohen.

Sa i përket këtij projektligji të gjithë janë pajtuar që të përfshihen të gjitha legjislaturat të vendit duke u përfshirë edhe ato të viteve të 90-ta lidhur me sigurinë dhe detyrat e deputetëve. Vetëm çështja e pensionit shtesë mund të jetë problematike. Ai ka pohuar se gati 90 për qind e deputetëve janë për procedim të Projektligjit për të drejtat dhe përgjegjësitë e deputetit në Kuvend.

Lidhur me projektin në fjalë, kemi disa propozime të reja. Ky komision propozon për çështjen e pensionit, për mundësinë e formimit të një fondi të posaçëm të Kuvendit, si dhe mundësia tjetër është që deputetët të cilin dalin në pension të parakohshëm të kenë mundësi të sistemohen si këshilltarë shtetërorë, duke e

marrë parasysh përvojën e deputetëve që mundë ta ofrojnë njohuri profesionale e sidomos në hartimin e ligjislacionit, kjo përvojë është duke u praktikuar edhe në vendet evropiane.

Albulena Haxhiu-ka ripërsëritur qëndrimin kundërshtues të subjektit të saj, ndaj pensioneve dhe privilegjeve dhe binificioneve të tjera të deputetëve. Në jemi në një gjendje shumë të vështirë ekonomike ku 45 për qind e popullsisë janë të papunë. Mendoj se është fytyrë për qytetarët e Kosovës, që deputetët të kenë gjitha këto privilegje të tilla. Ajo njëherë theksoi se duhet të ndermiret masa për nisma legjislative që t'u hiqen privilegjet edhe kryetarit të Kuvendit, kryeministrit, presidentes, kryetarit të gjykatës kushtetuese si dhe prokurorit të shtetit.

Armend Zemaj- në Kosovë nuk ka nevojë që prokuroria dhe gjyqësori, të kenë privilegje, ngase sipas tij ata nuk po bëjnë punën e tyre për të luftuar korupcionin dhe krimin. Andaj e përkrahi plotësisht mendimin e Znj. Albulena Haxhiut. Unë jam për të bërë dallim për funksionin që kanë, por për momentin nuk ka nevojë që të kenë privilegje.

Mbledhja përfundoi në ora 12.30.

Kryetar i Nënkomisionit

Armend Zemaj